REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TATIMPAGUESIT E MEDHENJ
Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit

Nr. 6263/1 Prot. Tiranë, më 30.04.2014

Lenda: Konfirmim Bilanci

Per: Z. KUJTIM ARIFAJ
Shoqeria: PE - VLA – KU .
NIPT: K61716013M
Adresa: Rruga Muzakët, Pallati Speed,
TIRANE

I nderuar Z. Arifaj

Në përgjigje të kërkesës Tuaj protokolluar me tonën Nr.6263 date 28.04.2014 me lendë "Kërkesë për konfirmim pasqyra financiare 2013", Ju dërgojmë

1- të njehsuar me origjinalin bilancin e vitit ushtrimor 2013 së bashku me pasqyrat shoqëruese të shoqërise "PE - VLA - KU" me nipt K61716013M të protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore të NJTM me Nr.45 date 24.03.2014.

DREJTOR RAJONAL
MIMOZA KALIA

Adresa: Rruga "Presidenti George W.Bush",
Tel/Fax: 270 974; Tel: 270 975, 270 972, 270 973
website:www.tatime .gov.al

"PE-VLA-KU"sh.p.k

Adresa :Rruga Muzaket,Pall SPEED Kati 2 , kontakt 0689022097,Email pevlaku shpk@yahoo.com Nipt K61716013

Nr 43 Prot. Tirane me 17.03.2014

45
24/3/14

Lenda: **Dorezim i Pasqyrave financiare te Firmes PEVLAKU shpk**

Drejtuar: **DREJTORISE RAJONALE TATIMORE TE TATIMPAGUESVE TE MEDHENJ**

TIRANE

Bashkengjitur keni Pasqyrat Financiare te Bilancit te vitit 2013 te Firmes PE-VLA- KU shpk si me poshte:

- Pasqyrat Financiare te vitit 2013
  - Raportin e Auditorit te Pavarur date 28.02.2014
  - Pasqyren Financiare te Aktiveve
  - Pasqyren Financiare te Pasiveve
  - Pasqyren Financiare te Ardhurave dhe Shpenzimeve
  - Pasqyren e Fluksit te Parase
  - Pasqyren e ndryshimeve ne Kapital
- Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare te Shoqerise
- Dekleraten e Administratorit
- Aktivet Afat gjate materiale
- Inventari i Mjeteve Kryesore ,amortizimi dhe gjendja me 31.12.2013
- Inventarin e mallrave me 31.12.2013
- Kontrata Qeraje zyre dhe Magazine per vitin 2013
- Formularin e Deklarimit dhe Pageses vjetore te tatim Fitimit 2013
- Vendimin e Asamblese se zakonshme te Ortakeve date 21.02.2014 per Miratimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2013 dhe perdorimin e Fitimit te ketij viti.

24/03/14

ADMINISTRATORI

PE-VLA-KU SHOQERI NDERTIMORE ALBANIA
Kujtim Arifaj
PE-VLA-KU
NIPT/K61716013M

DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TE SHQIPERISE
DREJTOR
MIMOZA KALIA

PE-VLA-KU sh.p.k
2013

Pasqyrat financiare vjetore

per periudhen

1 Janar 2013 deri me 31 Dhjetor 2013

DREITOR
MIMOZA KALIA

PE-VLA-KU SH.P.K
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M
SHQERIN DERTIMORE
ALBANIA

PASQYRA FINANCIARE
31 Dhjetor 2013

	AKTIVET	shenime	Viti Raportues 2013	Viti paraardhes 2012
I	**AKTIVE AFATSHKURTERA**			
1	**Aktive Monetare**			
	a.)Ne arke		206,735	683,565
	b.)Ne banke		652,917	11,032,408
	Totali 1	4	**859,652**	**11,715,973**
2	**Derivative dhe aktive te mbajtura per tregetim**		**0**	**0**
	a.)Derivativet			
	b.)Aktivet e mbajtura per tregetim			
	Totali 2		**0**	**0**
3	**Aktive te tjera finan.afatshkurtera**			
	a.)Kerkesa te arketueshme	5	1,311,314,528	1,273,844,723
	b.)Instrumenta te tjera borxhi(Tatim-fitimi mbingarkuar)		0	5,359,603
	c.)Instrumenta te tjera borxhi		0	0
	d.)Investime te tjera financiare		0	46,314,804
			0	0
			0	0
	Totali 3		**1,311,314,528**	**1,325,519,130**
4	**Inventari**			
	a.)Lendet e para	6	1,927,772	1,607,622
	b.)inventari imet dhe amballazhet		0	0
	g) lende djegese		0	0
	d.)Produkte te gatshme		0	0
	e.)Mallra per rishitje		8,720,968	23,441,124
	f.)Iparapagime per furnizimet		0	0
	Totali 4		**10,648,740**	**25,048,746**
5	**Aktivet biologjike afatshkurtera**		0	0
6	**Aktivet afatshkurtera per shitje**		0	0
7	**Parapagimet dhe shpenzime te shtyra**		0	0
	TOTALI I AKTIVEVE AFAT SHKURTER I		**1,322,822,920**	**1,362,283,849**
II	**AKTIVET AFATGJATA**			
1	**Investime financiare afatgjata**			
	a.)Aksione ne shoq.te kontrolluara			
	b.)Aksione te tjera dhe letra me vlere			
	c.)Kerkesa te arketueshme afatgjate			
	Totali 1		**0**	**0**
2	**Aktive afatgjata materiale**			
	a.)Toka			
	b.)Ndertesa(-amortizimi)			
	c.)Makineri dhe paisje (-amortizimi)		33,002,023	15,728,259
	d.)Mjete transporti (-amortizimi)		87,643,408	72,362,182
	e.)Te tjera AA Materiale(-amortizimi)			
	Totali 2	7	**120,645,431**	**88,090,441**
3	**Aktive afatgjata ne proces**		**0**	**0**
4	**Aktive afatgjata biologjike**		**0**	**0**
5	**Aktive afatgjata per shitje**		**0**	**0**
6	**Aktive afatgjata jomateriale**		**0**	**0**
7	**Kapitali aksionar i papaguar**			
	Totali Aktiveve Afat Gjate II		**120,645,431**	**88,090,441**
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)		**1,443,468,351**	**1,450,374,290**

DREJTOR
MIMOZA KALIA

PE-VLA-KU SH.P.K. ALBANIA SHOQERI NDERTIMORE
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M

Hartuar nga

PASQYRA FINANCIARE (Vazhdim)
31 Dhjetor 2013

	PASIVET	shenime	Viti Raportues 2013	Viti paraardhes 2012
	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	DETYRIMET AFATSHKURTERA			
1	**Derivativet**		0	0
2	**Huamarrjet**		32,965,689	67,979,291
	a.)Huate dhe Oblig.afatshkurtera		32,965,689	67,979,291
	b.)Kthimet/Ripagesat huave afatgjata			
	c.)Bono te konvertueshme			
	Totali 2		**32,965,689**	**67,979,291**
3	**Huat dhe parapagimet**			
	a.)Detyrimet ndaj furnitorve		970,179,083	1,070,494,813
	b.)Detyrimet ndaj punonjesve		0	0
	c).Detyrime tatimore dhe ndaj Sig.Shoqerore		18,350,702	11,920,356
	d)Huara te tjera		210,411,909	160415170
	e.)Detyrime ndaj aksioneve /ortakve			
	f.)Parapagimet e arketuara			
	g.)Kreditor te ndryshem		959,851	0
	Totali 3		**1,199,901,545**	**1,242,830,339**
4	**Grantet dhe t'ardhura te shtyra**			
5	**Provizione afatshkurtera**			
	TOTALI DETYRIMEVE AFATSHKURTERA (I)	8	**1,232,867,234**	**1,310,809,630**
II	**DETYRIME AFATGJATA**			
1	**Hua Afat Gjate**			
	i) Hua ,bono dhe detyrime nga qeraja financiare	9	16,131,710	8,348,939
	ii)Bonot konvertueshme			
	Totali 1		**16,131,710**	**8,348,939**
2	Huara te tjera Afatgjate		0	0
3	**Provizione Afatgjate**		0	0
4	**Grande dhe te ardhura te shtyra**		0	0
	TOTALI I DETYRIMVE AFATGJATE (II)		**16,131,710**	**8,348,939**
			0	0
III	**K A P I T A L I**			
1	Aksionet e pakices			
2	Kapitali qe u perket vetem aksionete shoqerise meme			
3	Kapitali regjistruar akisonere		65,600,000	65,600,000
4	Primi aksionit			
5	Njesite me aksionet e thesarit			
6	Rezerva statutore			
7	Rezerva ligjore		7,779,416	7,779,416
8	Rezerva te tjera		37,945,720	37,945,720
9	Fitimi dhe humbja e pashperndare		0	0
10	Fitimi dhe humbja e vitit financiare		83,144,271	19,890,585
	TOTALI KAPITALIT (III)	10	**194,469,407**	**131,215,721**
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I+II+III)		**1,443,468,351**	**1,450,374,290**

Hartuar nga

Kajtim Hajdaj

Gjergji Fejzo

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
31 Dhjetor 2013

	Pershkrimi I elementeve	shenime	Viti Raportues 2013	Viti paraardhes 2012
I	**Totali I te ardhurave (1+2)**	11	**887,594,675**	**1,231,754,025**
1	Shitjet neto (produkte dhe mallra)		97,280,473	233,976,271
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit (qera,grante,aktive,te tjera)		790,314,202	997,777,754
3	Nga ndryshimi gjendjeve te prodhimit ne proces dhe produkteve te gatshme		0	0
4	Materiale dhe mallrat e konsumuara	12	**-683,429,525**	**-1,132,993,847**
5	Kosto e punes	13	**-46,269,328**	**-44,278,950**
	a.)Pagat		-41,444,760	-39,748,540
	b.)Shpenzimet per Sigurimet shoqerore dhe shendetsore		-4,824,568	-4,530,410
7	Amortizimet dhe zhvlersimet		**-21,129,700**	**-2,339,701**
8	Shpenzime te tjera te shfrytezimit(pjesa tjeter e shpenzimeve operative)	14	**-39,730,962**	**-17,951,542**
II	**Totali Shpenzimeve (4-7)**		**-790,559,515**	**-1,197,564,040**
9	***Fitime ose Humbje (-) nga veprimtaria kryesore (I - II)***		**97,035,160**	**34,189,985**
III	**Te Ardhurat dhe shpenzimet financiare (+ -)**			
10	Te ardhura nga shpenz financiare nga njesite e kontrolluara		0	0
11	Te ardhura dhe shpenzime financiare nga pjesemarrjet		0	0
12	Te ardhura dhe shpenzime financiare		**-4,382,999**	0
	Te ardhura dhe shpenz financiare nga investimet			
	Te ardhura dhe shpenzime nga interesta (767,667)		-4,155,894	-12,118,384
	Fitime e humbje nga kursi kembimit		-228,495	17,164
	Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare		1,390	471,922
13	Totali I te te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		**-4,382,999**	**-11,629,298**
14	***Fitimi (+) ose Humbje(-) para tatimit (I - II + - III)***		**92,652,161**	**22,560,687**
15	***Shpenzime Tatim Fitimi totale***	15	**9,507,890**	**2,670,102**
	a)Shpenzimet e tatimit mbi fitimin (tatim-fitimi 10%)		9,265,216	2,256,069
	b)Shpenzime te panjohura (2.426.733 X 10 %)		242,674	414,033
16	***Fitimi (+) ose Humbje(-) neto e vitit financiar (I bilancit)***		**83,144,270.90**	**19,890,585**
	Rentabiliteti ne % (D27/D15)		**-11.72**	**-1.88**

Hartuar nga

DREJTOR
MIMOZA KALIA

PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASE
31Dhjetor 2013

Pasqyra Fluksit monetare -Metoda indirekte	shenime	Viti Raportues 2013	Viti paraardhes 2012
Fluksi monetare nga veprimtaria e shfrytezimit			
Fitimi para tatimit		92,652,161	22,560,687
Rregullime per			
Amortizimin		21,129,700	2,339,701
Humbje nga kembimet valutore			
Te ardhura nga investimet			
Shpenzime per interesa		0	0
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti		14,204,602	-743,465,640
Rritje/renie ne tepricen e inventarit		14,400,006	35,084,755
Rritje/renie e detyrimeve per tu paguar		-77,942,396	732,685,283
Rritje/renie shpenzimeve shtyra		0	-246,177
Mjete monetare te perfituara nga aktiviteti		**64,444,073**	**48,958,609**
Interes I paguar			0
Tatim mbi fitimin I paguar		-9,507,890	-2,670,102
Mjete monetare neto nga aktiviteti I shfrytezimit		**54,936,183**	**46,288,507**
Fluksi monetare nga veprimtaria investuese		0	0
Blerje e shoqerise se kontrolluar x minus parate e arketuara		0	0
Blerje e aktiveve afatgjate materiale		-69,192,845	-16,795,415
Te ardhura nga shitja e pajisjeve		*17,429,000*	4,601,499
Interesi areketuar		0	0
Devident I arketuar		0	0
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetin investues		**-51,763,845**	**-12,193,916**
Fluksi monetare nga veprimtaria financiare		0	0
Hyrje nga emetimi kapitali aksionare		0	0
Hyrje nga huamarrja afatgjate		7,782,771	-26,712,242
Pagesat e detyrimeve te qerase financiare		-1,920,845	0
Devidente I paguar		-19,890,585	-10,000,000
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet financiare		**-14,028,659**	**-36,712,242**
Rritje / renie e mjeteve monetare		**-10,856,321**	**-2,617,651**
Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel		**11,715,973**	**14,333,624**
Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel		**859,652**	**11,715,973**
		-10,856,321	-2,617,651

Hartuar nga

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
31 Dhjetor 2013

PERSHKRIMI	Kapitali I regjistrua aksionere	Primi aksionit	Rezerva ligjore statutore	Rezerva te tjera	Fitimi Ushtrimore	Totali
Pozicioni me 31.12.2010	65,600,000		7,181,954		597,462	73,379,416
Efekti I ndryshimit ne politikat kontabel						0
Shperndarja e fitimit 2010			597,462		-597,462	
Fitimi neto I periudhes kontabel					47,945,720	47,945,720
Devidente I paguar						0
Rritja e rezerves se kapitalit						0
Emetimi I kuotave (aksioneve)						0
Pozicioni me 31.12.2011	65,600,000	0	7,779,416		47,945,720	121,325,136
Shperndarja e fitimit 2011				37,945,720	-37,945,720	0
Fitimi neto I periudhes kontabel					19,890,585	19,890,585
Devidente I paguar					-10,000,000	-10,000,000
Emetimi kapitali aksionere						0
Rritja e rezerves se kapitalit						0
Aksione te thesarit te riblera						0
Pozicioni me 31.12.2012	65,600,000		7,779,416	37,945,720	19,890,585	131,215,721
Shperndarja e fitimit 2012						0
Fitimi neto I periudhes kontabel					83,144,271	83,144,271
Devidente I paguar					-19,890,585	-19,890,585
Emetimi kapitali aksionere						0
Rritja e rezerves se kapitalit						0
Aksione te thesarit te riblera						0
Pozicioni me 31.12.2013	65,600,000		7,779,416	37,945,720	83,144,271	194,469,407

Pasqyrat financiare të Shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 u aprovuan nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise dhe u nenshkruan si me poshte me 30 Janar 2014.

Z. Kujtim Arifaj
Administratori

PE-VLA-KU SH.P.K
PE-VLA-KU
NIPT. K61716013M
ALBANIA · SIGURIMI I NDERTIMORE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREITOR
MIMOZA KALIA

Shenime per pasqyrat financiare te shoqerise

1. Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria "PE-VLA-KU " sh.p.k eshte rregjistruar ne Rregjistrin e Shoqerive me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr.34,297 date 07.11.2005.
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte veprimtari ne fushen e ndertimeve.
Kapitali themeltar i shoqerise ne gjate vitit ushtrimor 2013 kapitali nuk ka ndryshuar, ai eshte ne shumen 65,600,000 leke.
Kapitali themeltar i shoqerise zotrohet nga tre ortake te saje qe jane Z.Petrit IMERAJ, Z.Kujtim ARIFAJ dhe nga Z.Vladimir PJETERGJOKAJ.
Shoqeria e ka seline ne Tirane,Rruga Muzaket,pallati Speed kati 2-te.
Administrator i shoqerise eshte Z. Kujtim ARIFAJ

Shoqeria "PE-VLA-KU " sh.p.k gjate vitit ushtrimor 2013 ka ushtruar aktivitet ne fushen e ndertimit dhe rikonstruksioneve te ndryshme.
Shoqeria eshte e rregjistruar prane deges se Tatim Taksave Tirane dhe ka paguar rregullisht detyrimet tatimore.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).
Shoqeria mban regjistrimet kontabel dhe pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me legjislacionin kontabel dhe tatimor ne Shqiperi.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Vijueshmeria

Pasqyrat finaciare paraqiten sipas parimit te vijimesise, qe do te thote se veprimtaria ekonomike e organizates do te kete vijimesi, dhe se nuk ka ne plan ose nuk do ta kete te nevojshme ta nderprese aktivitetin e saj.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshoje në varësi të këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.
Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

PE-VLA-KU SH.P.K
NIPT: K61716013M
SHËRBIME TRANSPORTI
ALBANIA

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vleren e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta te përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

iii. Amortizimi (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	**Përqindja**
Makineri dhe pajisje	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	25%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare te mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

PE-VLA-KO SHPK NIPT: K61716013M ALBANIA

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare detajohen si me poshte:

	2013	2012
Parate ne arke	206,735	683,565
Llogarite bankare	652,917	11,032,408
Totali	**859,652**	**11,715,973**

PE-VLA-KU " sh.p.k operon me disa banka.Gjate vitit ushtrimor shoqeria ka kryer transaksione me te gjitha bankat. Kontabilizimi i bankave eshte bere rregullisht. Gjendjet e bankave ne fund te vitit rakordon me shifrat e bilancit.
Teprica e llogarive bankare jane te kuadruara, ato perputhen me shumen e ekstrakteve te bankave me 31.12.2013. Gjendjet e llogarive ne valute jane konvertuar me kursin e bankes se Shqiperise ne 31.12.2013.
Ne postin e likujditeteve arka paraqitet me gjendjen 206,735 leke dhe perputhet me gjendjen e arkes te dates 31.12.2013. Dokumentacioni eshte ne perputhje me ligjin per kontabilitetin.

5. Klientet dhe kerkesa te tjera te arketueshme

Klientet dhe kerkesa te tjera te arketueshme detajohen si me poshte:

	2013	2012
Klient kerkesa te arketueshme	1,311,314,528	1,273,844,723
Tatim mbi fitimin	-	5,359,603
Te arktueshme te tjera	-	46,314,804
Totali	**1,311,314,528**	**1,325,519,130**

Ne postin " Kerkesa te arketueshme", Paraqitet vlera 1,311,314,528 leke e cila perputhet me analizen e klientit te bere nga shoqeria.

6. Inventari

	2013	2012
Lendet e para	1,927,772	1,607,622
Mallra per rishitje	8,720,968	23,441,124
Totali	**10,648,740**	**25,048,746**

Paraqitet ne kontabilitet me shumen 10,648,740 leke ne mbyllje te vitit ushtrimor nga 25,048,746 leke qe ishte ne celje. Gjendja perfaqeson lendet e para dhe materialet ne magazine ne 31.12.2013. Ne krahasim me vitin 2012 gjendja e inventarit eshte ulur me 14,400,006 leke.
Ne postin "Mallra per rishitje" paraqitet shuma 8,720,968 leke e cila perfaqeson shumen e mallrave te blera per rishitje.
Ne fund te vitit ushtrimor shoqeria ka kryer inventarin fizik shuma e inventarit perputhet me gjendjen ne bilanc. Lendet e para dhe mallrat ne magazine ndiqen dhe evidentohen ne llogarine perkatese me metoden e "Inventarit te ndermjetem" dhe vlersohen me koston e marrjes se tyre.

PE-VLA-KU SH.P.K SHOQERI NDERTIMORE ALBANIA
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M

7. Aktive afatgjata materiale

	Gjendjet dhe levizjet	Ndertesa	Paisje zyre dhe informatike	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2013		2,381,808	17,675,942	85,187,870	105,245,624
	Shtesat		324,117	23,034,556	45,834,172	69,192,845
	Pakesimet		-	31,288	20,565,556	20,596,844
	Kosto e AAM-ve 31.12.2013		2,705,925	40,679,210	110,456,486	153,841,625
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2013		725,264	3,604,228	12,825,688	17,155,180
	Amortizimi ushtrimit		422,111	5,644,669	15,062,920	21,129,700
	Amortizimi per daljet e AAM-ve		-	13,159	5,075,530	5,088,689
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2013		1,147,375	9,235,738	22,813,078.33	33,196,191
C	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2013		1,656,544	14,071,714	72,362,182	88,090,444
						0
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2013		1,558,550	31,443,472	87,643,408	120,645,431

Aktivet jane paraqitur ne bilanc ne vlere neto pra duke i zbritur amortizimin.
Krahasuar me gjendjen ne celje te ushtrimit totali i Aktiveve te Trupezuara bruto eshte rritur me 48,596,001 leke. Shtesa ne vitin ushtrimor ne pjesen me te madhe te tyre perfaqeson blerje te disa mjeteve te renda te transportit, blerje te disa makineri e paisjeve si dhe blerje te paisjeve zyre dhe informatike.

8. Huamarrjet dhe parapagimet

Huamarrjet paraqiten te detajuara si me poshte:

	2013	2012
Hua dhe obligacione afateshkurtera	32,965,689	67,979,291
Te pagueshme ndaj furnitoreve	970,179,083	1,070,494,813
Detyrimet tatimore	18,350,702	11,920,356
Hua te tjera	210,411,909	160,415,170
Kreditore te ndryshem	959,851	
Totali	**1,232,867,234**	**1,310,809,630**

Ne postin **"Hua dhe obligacione afateshkurtera „** (8.1)

Paraqitet shuma 32,965,689 leke qe perfaqeson overdraft te marre nga banka per ushtrimin normal te veprimtarise se shoqerise .

Ne postin **"Furnitor per blerje dhe sherbime „** (8.2)

Paraqitet shuma 970,179,083 leke qe perfaqeson detyrimin e shoqerise ndaj disa furnitoreve per blerje te ndryshme materialesh ndertimi dhe mallrash.
Detyrimet e mesiperme jane te analizuara dhe shuma e analizes perputhet me kontabilitetin.

Ne postin **Detyrime Tatimore = 18,350,702 leke** (8.3)

Ne bilanc paraqitet detyrimi ne shumen 18,350,702 leke qe perfaqsojne detyrimet si me poshte :
- Tatim mbi Vleren e Shtuar te muajit Dhjetor 2013 ne shumen 16,388,937 leke.

PE-VLA-KU SH.P.K
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M
ALBANIA · SHOQERI NDERTIMORE

- Sigurimet e muajit Dhjetor 2013 ne shumen 720,648 leke, llogaritja dhe derdhja e sigurimeve shoqerore eshte bere rregullisht.
Tatim mbi pagat per mujain Dhjetor 2013 ne shumen 267,650 leke. Te tre detyrimet e mesiperme jane likujduar ne Janar 2014.

Ne postin **Hua te tjera = 210,411,909 leke** (8.4)
Ne kete post pasqyrohet shuma e huase afateshkurter te dhenen shoqerise nga ortaket e saj.

9. Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare

Paraqitet ne bilanc ne shumen 16,131,710 leke dhe ne te paraqitet qeraja financiare e marre nga Tirana Lesing, si me poshte:

	2013	2012
Hua,bono thesari, detyrime nga qeraja financiare	16,131,710	8,348,939
Totali	**16,131,710**	**8,348,939**

10. Kapitali

	2013	2012
Kapitali aksionar	65,600,000	65,600,000
Rezervat ligjore	7,779,416	7,779,416
Rezerva te tjera	37,945,720	37,945,720
Fitimi (Humbja) e vitit financiar	83,144,271	19,890,585
Totali	**194,469,407**	**131,215,721**

Ne 31.12.2013 kane arritur ne shumen 194,469,407 leke nga 131,215,721 leke qe ishin ne celje te ushtrimit. Rritja ka ardhur nga fitimi i periudhes ushtrimore ne shumen 83,144,271 leke dhe eshte zvogeluar nga shperndarja e dividenteve per shumen 19,890,585 leke.

Kapitali themeltar (10.1)

Gjate vitit ushtrimor 2013 kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 65,600,000 leke. Kapitali themeltar i shoqerise eshte depoziatuar ne rregjistrin themeltar te shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane.

"Rezerva ligjore" (10.2)

Paraqitet ne bilanc me vlere 7,779,416 leke dhe ne te paraqitet rezerva ligjore e viteve te kaluara.

"Fitime ose humbje te ushtrimit"

Paqyrohet ne bilanc me vleren 83,144,271 leke dhe perfaqeson fitimin e periudhes ushtrimore.

PE-VLA-KU SH.P.K SHOQERI NDERTIMORE ALBANIA
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M

11. Shitjet

Analiza e te ardhurave te Shoqerise eshte si me poshte:

	2013	2012
Te ardhura nga shitja	97,280,473	233,976,271
Te ardhura nga kryerja e sherbimeve	790,314,202	997,777,754
Totali	**887,594,675**	**1,231,754,025**

Sic shihet, te ardhurat ne total per periudhen ushtrimore jane ne shumen 887,594,675 leke.
Shuma e te ardhurave e pasqyruar ne bilanc perputhet me shumen e faturave te shitjeve, ajo perputhet me shumen e fdp –ve.
Te ardhurat e shoqerise jane te kontabilizuara ne mbeshtetje te dokumentave justifikuese.

12. Kosto e lendeve te para e materialeve

	2013	2012
Lende te para dhe materiale	683,429,525	1,132,993,847
Totali	**683,429,525**	**1,132,993,847**

Peshen specifike me te madhe ne totalin e shpenzimeve e ze zeri " Materiale te para dhe materiale te tjera " te cilat perfaqesojne blerjet e vitit ushtrimor. Nga verifikimi rezultoje se ne kete ze jane permbledhur blerjet e vitit per materialet te perdorura per ndertimin. Pothuajse te gjitha shpenzimet e ketij zeri jane me fature tatimore me tvsh.

13. Kostot e punes

Ne keto shpenzime te paraqitura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve paraqiten zerat e shpenzimeve si me poshte:

	2013	2012
Pagat e punes	41,444,760	39,748,540
Sigurimet shoqerore	4,824,568	4,530,410
Totali	**46,269,328**	**44,278,950**

14. Shpenzime te tjera

Pasqyrohet shuma 39,730,962 leke dhe ne te perfshihen shpenzimet per sherbime komisione bankare, shpenzime telefoni energje si dhe shpenzime te ndryshme.

PE-VLA-KU SH.P.K SHOQERI NDERTIMORE ALBANIA
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M

15. Shpenzime te tatim fitimit

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin i paraqitur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve detajohet si me poshte:

	2013	2012
Fitimi (humbja) i/e vitit para tatimit	92,652,161	22,560,687
Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal	2,426,733	4,140,333
Fitimi i tatueshem	95,078,894	26,701,020
Tatim Fitimi	**9,507,889**	**2,670,102**

Perqindja e tatimit mbi fitimin per vitin 2013 sipas legjislacionit fiskal shqiptar eshte 10%. Deklarimi i pageses se tatim fitimit behet cdo vit por fitimi dhe humbja fiskale mbeten te perllogaritura derisa te kontrollohen nga autoritetet tatimore.

16. Ngjarje mbas dates se bilancit

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

PE-VLA-KU SH.P.K SHQERIN DERTIMORE ALBANIA
PE-VLA-KU
NIPT: K61716013M

ild
AUDIT & ACCOUNTING

Adresa Rr. Ismail Qemali
Pall. 34/1 Ap. 2/1
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 2278 028
(+355 4) 2270 900
Email : luan.kamberi@ild-99.com

RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR

Drejtuar : "*Asamblese se Ortakeve te Shoqerise « PE-VKA-KU »sh.p.k*

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare Individuale te " PE-VLA-KU "sh.p.k (me poshte shoqeria) që përfshijnë bilancin individual më 31 Dhjetor 2013, pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe pasqyren e flukseve te parave per vitin e mbyllur ne kete date si dhe një permbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme per rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojme kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin proçedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Nje auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërine e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Individuale paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te shoqerise " PE-VLA-KU " sh.p.k me 31.12.2013 te rezultatit te saj financiar dhe te flukseve te saj te parave ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Ekspert Kontabël i Rregjistruar
" I.L.D. – 99 Audit " sh.p.k.
Luan KAMBERI
Rruga " Ismail Qemali" pall 34/1 pall2/1 Tirane

Tiranë, më 28 Shkurt 2014